

PLANI I VEPRIMIT I TELEKOMUNIKACIONIT

	Detyrat	Përgjegjës	Fillimi	Përfundimi	Komente
6	Një grup implementues do të formohet, me lehtësim nga BE sipas nevojës, me qëllim të hartimit të një plani të plotë veprimi për zbatimin e marrëveshjes. Pas hyrjes në fuqi të aranzhimeve të mësipërme, grupi implementues mund të diskutoj, me kërkesë të secilës palë, çfarëdo çështje tjetër që lidhet me këtyre marrëveshjeve. Procesi i zbatimit të plotë do të filloj pas pranimit me shkrim të planit të veprimit.	Grupi Kryesor			Çdo kërkesë për një modifikim të mundshëm të infrastrukturës mobile të ndërmarrjes së re (NewCo) mund të ngritët në kuadër të këtyre diskutimeve.
6.1	Nominimi i personave kontaktues / krijimi i 3 nën-grupeve 1. Bashkëpunimi rregullator 2. Operatorët 3. Shërbimet Postare	Grupi Kryesor	15/01	15/01	
6.2	Draftimi i Planit të Veprimit	Grupi Kryesor	15/01	29/6	
6.3	Pranimi me shkrim i Planit të Veprimit	Grupi Kryesor Korniza Politike		1/09	
1.0	Në kontekst të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, të dy palët pajtohen që Kosovës do t'i ndahet një kod telefonik 3-shifror nga ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit) në përputhje me standardet, parimet dhe oraret e ITU-së. Të dy palët janë pajtuar që një modalitet i pranueshëm nga të dyja palët do të gjendet lidhur me këtë proces brenda 3 muajsh, me lehtësimin nga BE-ja sipas nevojës.	Grupi Kryesor			
1.1	Qasja në ITU me lehtësimin nga BE-ja sipas nevojës	Grupi Kryesor	15/11		Është arritur pajtueshmëria që Austria të dërgoj letrën në ITU për të filluar këtë procedurë. Përmbajtja e kësaj letre është në Aneksin 2 të këtij Plani të veprimit.
1.2	Alokimi (Ndarja) i kodit 3-shifror telefonik. Të dyja palët janë pajtuar që vetëm Kosova do të ketë përgjegjësinë për implementimin e këtij kodi, pasi që Kosovës t'i ndahet kodi 3-shifror nga ITU. ITU do të komunikoj me ARKEP si administrator i vetëm i këtij kodi, sipas nevojës.	Grupi Kryesor		15/01/2016	ITU publikon buletinet e saj më datë 1 dhe 15 të muajit. Teksti i buletinit të ITU-së është në Aneksin 1 të këtij Plani të Veprimit. Emërtimi (denominimi) i Kosovës në anekset teknike të

					ITU-së është në Aneksin 3 të këtij Plani të Veprimit.
1.5	Qëllimi është që periudha e migrimit të kodit telefonik duhet të përfundoj deri në janar të vitit 2015. Pas kësaj date, ky kod telefonik nga ITU do të përdoret nga të gjithë operatorët në Kosovë. Operatorët nga të dyja palët do t'i ulin kostot deri në tarifa lokale për qytetarët.	Grupi Kryesor Bashkëpunimi Rregullator Operatorët	1/04/2016	1/07/2017	Gjithashtu duhet të përfshihet edhe ndërmarrja e re (NewCo). (shih pikat 3 dhe 4 më poshtë: vetëm operatorët e autorizuar nga ARKEP do të jenë në gjendje të operojnë në Kosovë).
1.6	Strategjia e migrimit do draftohet nga ARKEP, duke përfshirë planin e ri të numeracionit nën kodin e ri thirrës. ARKEP do të siguroj që nuk ka asnjë shkelje/konflikt ndërmjet palëve të planit të numeracionit mobil dhe fiks Strategjia e migrimit do të thekson që ky kod thirrës duhet të përdoret nga të gjithë operatorët në Kosovë.	ARKEP Bashkëpunimi rregullator	01/01/2016	1/04/2016	Nëse ndonjë operator kërkon një shtyerje (vonesë) shtesë, ai mund të paraqesë kërkesë pranë ARKEP. Ndërmarrja e re sipas mundësive (zgjidhjes) teknike do i mundësohet të lejoj përdoruesit e saj të mos përdorin kodin thirrës ndërkombëtar të Serbisë kur thërrasin nga Kosova.
1.7	Operatorët nga të dy palët do të zvogëlojnë kostot deri në tarifa lokale për qytetarët, sipas praktikave të BE-së. Të dy palët do të sigurojnë që nuk do të ketë pengesa institucionale, legale dhe procedurale për të bërë këtë.	Bashkëpunimi Rregullator Operatorët	1/10	01/02/2016	
2.0	Rregullatorët në të dy anët do të arrijnë (pajtojnë) marrëveshjet teknike për harmonizimin e përdorimit të spektrit për GSM dhe sinjale televizive, përfshirë transmetimet digjitale tokësore, me qëllim të sigurimit të ofrimit të ndërsjellët e të pa-ndërprerë të shërbimeve bazuar në parimet e ITU-së dhe shmangies së interferencës së dëmshme në mes shërbimeve. Secila palë zotohet të mos e mbuloj me qëllim kufirin e palës tjetër.	Bashkëpunimi rregullator			
2.1	Definimi i të dhënave teknike për t'u shkëmbyer për pikën 2.2	Bashkëpunimi rregullator	01/09	15/09	Pas kësaj date, të dhënat të shkëmbehen në mënyrë të vazhdueshme dhe sa herë është e nevojshme

2.2	Rregullatorët do të nënshkruajnë marrëveshjet teknike për të harmonizuar përdorimin e spektrit radio frekuencor për telefoninë mobile me një synim të shmangies se interferencave të qëllimshme ndërmjet shërbimeve dhe të mos mbulimit të kufirit të palës tjetër në mënyrë të qëllimshme.	Bashkëpunimi rregullator Marrëveshjet për t'u aprovuar nga Grupi kryesor	15/09	01/03/2016	Pas kësaj date, të dhënat të shkëmbehen në mënyrë të vazhdueshme dhe kur është e nevojshme
2.5	Rregullatorët po ashtu do të inkurajojnë dhe lehtësojnë procesin e arritjes së marrëveshjes së interkoneksionit dhe roamingut në mes operatorëve mobil të të dyja anëve me qëllim zvogëlimin e kostove për qytetarët. Ata po ashtu do të fillojnë një proces të harmonizimit për frekuencat digjitale.	Bashkëpunimi rregullator			
2.6	Rregullatorët do të inkurajojnë operatorët fikse ekzistues që të hyjnë në marrëveshje të interkoneksionit me operatorët fikse të palës tjetër. Rregullatorët do të inkurajojnë operatorët mobil ekzistues që të hyjnë në marrëveshje të interkoneksionit dhe roamingut me operatorët mobil të palës tjetër.		1/10	1/02/2016	Këto marrëveshje duhet të marrin parasysh iniciativat tjera regionale, të cilat promovojnë reduktimin e tarifave të roamingut për të gjithë operatorët e autorizuar nga Rregullatorët nga të dy anët. Gjithashtu e lidhur me 1.7
2.7	Rregullatorët do të nënshkruajnë marrëveshje teknike për harmonizimin e spektrit të transmetimit tokësor digjital dhe analog me qëllim të shmangies së interferencave të qëllimshme ndërmjet shërbimeve dhe të mos mbulohet kufiri i palës tjetër në mënyrë të qëllimshme.	Bashkëpunimi rregullator Marrëveshjet për t'u aprovuar nga Grupi kryesor	1/10	01/03/2016	Institucione tjera përgjegjëse duhet të përfshihen. Procedurat e përmendura me sipër do të lënë gjerësi të mjaftueshme të brezit në multiplex për transmetimet ekzistuese për popullatën serbe.
3.0	Për telefoninë fikse, një licencë e plotë për shërbime telekomunikuese fikse do t'i lëshohet një ndërmarrje të re, degë e një ndërmarrje serbe të regjistruar në përputhje me kornizën rregullative të Kosovës.				Infrastruktura telekomunikuese aktuale fikse aktive duhet të mirëmbahet rregullisht deri sa licenca të lëshohet në 3.4
3.1	Definimi i ndërmarrjes së re (regjistri i pajisjeve - inventari, shërbimet, infrastruktura dhe zgjerimi i rrjetit, modi i funksionimit të ndërmarrjes së re para dhe gjatë periudhës së migrimit sipas pikës 1.5) dhe themelimi ligjor.	Operatorët Drafti për t'u aprovuar nga Grupi kryesor	1/09	01/12	

3.2	Regjistrimi i ndërmarrjes së re në Kosovë, në përputhje me Kornizën Ligjore të Kosovës.	Grupi kryesor	13/5	31/08	Është arritur pajtimi që do të jetë një ndërmarrje, degë e ndërmarrjes serbe, e cila do të aplikoj për licencën fikse dhe autorizimin e përkohshëm për operimet mobile. Afati i fundit për dhënien e licencës së biznesit të ndërmarrjes, në përputhje me Kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
3.3	Aplikimi tek Rregullatori ARKEP për autorizim për shërbimet telekomunikuese fikse	Bashkëpunimi rregullator Operatorët	15/11		Afati i fundit përputhje me Kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
3.4	Lëshimi i autorizimit. Ky autorizim do të dërgohet tek lehtësuesit e BE-së më 01/01/2016, për të hyrë në fuqi vetëm kur të dorëzohet tek operatori. Lehtësuesi i BE-së do të dorëzojë atë tek operatori kur Kosovës do t'i alokohet kodi thirrës 3-shifror nga ITU.	ARKEP		15/01/2016	Orari për të lëshuar licencën në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës.
3.5	Tranferimi i asetëve fikse (siç definohet në 3.1) dhe punëtorët në ndërmarrjen e re	Bashkëpunimi rregullator Operatorët Për tu aprovuar nga Grupi Kryesor	26/08	15/12	BE do të lehtësojë transferin e asetëve fikse që do të përdoren nga ndërmarrja e re (NewCo). Asetet, të cilat aktualisht përdoren nga ndërmarrja serbe (siç definohet në 3.2) do të transferohen tek ndërmarrja re.
4.0	Për telefoninë mobile, autoritetet e Kosovës do t'i lejojnë ndërmarrjes së re një autorizim të përkohshëm, sipas kornizës rregullative të Kosovës, për operacionet aktuale, të kufizuar brenda infrastrukturës aktuale në terren. Ky autorizim i përkohshëm nuk do të skadojë para janarit të vitit 2015. Autorizimi i përkohshëm do të skadojë atëherë kur autoritetet e Kosovës japin një licencë të plotë, të pa-kufizuar për telefoninë mobile si rezultat				Infrastruktura telekomunikuese aktuale fikse aktive e ndërmarrjes së re duhet të mirëmbahet rregullisht deri sa t'i lëshohet licenca në 4.2

	i një tenderi/ankandi. Tenderi do të organizohet në përputhje me standardet e BE-së.				
4.1	Dorëzimi i kërkesës për autorizim të përkohshëm	Bashkëpunimi rregullator Operatoret	15/11		Ky dorëzim duhet të behet në të njëjtën kohë kur të dërgohet letra nga Austriake për vëmendje të ITU – shiko 1.1
4.2	Lëshimi i autorizimit të përkohshëm Ky autorizim i përkohshëm dërgohet tek lehtësuesi i BE-së më 01/01/2016, për të hyrë në fuqi vetëm kur të dorëzohet tek operatori. Lehtësuesi i BE-së do të dorëzoj atë tek operatori kur Kosovës do t'i alokohet kodi thirrës 3-shifror nga ITU. Ky autorizim i përkohshëm nuk do të skadoj para datës 01/03/2017	ARKEP		15/01/2016	Ky autorizim dërgohet në të njëjtën ditë kur kodi i ITU i alokohet/caktohet Kosovës (shiko pikën 1.2).
4.3	Negociimi i marrëveshjes së interkoneksionit ndërmjet ndërmarrjes së re dhe operatoreve tjerë të autorizuar	Bashkëpunimi rregullator Operatoret	01/10	01/02/2016	
4.4	Transferi i asetëve fikse për telefoninë mobile (siç definohet në 4.1) tek operatori i ri.	Bashkëpunimi rregullator Operatorët Për tu aprovuar nga Grupi Kryesor	26/08	15/12	
5.0	Ndonëse shërbimet postare nuk kanë qenë pjesë e këtyre diskutimeve, të dy palët janë pajtuar t'i diskutojnë ato në një fazë të mëvonshme.	Grupi i shërbimeve postare	01/12		

Grupet Punuese: Kosova

Grupi punues mbi bashkëpunimin rregullator
Operatorët
Grupi i shërbimeve postare

z. Ekrem Hoxha nga ARKEP (ekrem.hoxha@arkep-rks.org)

z. Ilir Imeri (ARKEP) / z. Mehdi Latifaj (PTK)

z. Sejdi Hoxha, Kryeshef Ekzekutiv nga Posta e Kosovës (sejdi.hoxha@ptkonline.com)

Grupet Punuese: Serbia

Grupi punues mbi bashkëpunimin rregullator
Operatorët
Grupi i shërbimeve postare:

z. Milan Jankovic nga RATEL /

z. Milan Aleksijevic (Telekom Srbija)

z. Vladimir Dimitrijević (Posta e Serbisë)

Aneksi 1: Teksti i buletinit të ITU

Me pajtimin e Administratës së Republikës së Serbisë, Drejtori i TSB i cakton Kosovës kodet ndërkombëtare si në vijim:

Kodi E.164 (siç është i definuar në Rekomandimin ITU-T E. 164 paragrafi 4.1): 383

Kodi E.212 (siç është i definuar në Rekomandimin ITU-T E. 212 paragrafi 3.3): 221

Q.708 Kodi i sinjalizimit të Rrjetit të Zonës (SANC): 7-214

Datat e aktivizimit të këtyre kodeve dhe kalimi nga kodet aktuale që janë duke u përdorur tek këto kodet e caktuara, do të njoftohen/këshillohen më vonë.

Aneksi 2: Teksti i letrës austriake për ITU

I dashur Sekretar i përgjithshëm,

Në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kam nderin të kërkoj, në emër të Serbisë dhe Kosovës, që Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve të filloj procesin e alokimit të kodit thirrës 3 shifror për Kosovën.

Si pjesë e dialogut të përmendur më lartë, Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë arritën një marrëveshje në Shtator 2013 që Kosovës duhet t'i alokohet një kod thirrës 3-shifror, në përputhje me standardet, parimet dhe kalendarin e ITU-së. Të dy palët gjithashtu u pajtuan që një modalitet i pranueshëm nga të dyja palët do të gjendet në lidhje me këtë proces, me lehtësimin e BE-se nëse është e nevojshme. Do të doja të ju informoj juve që të dy palët janë pajtuar që ky modalitet i pranueshëm të jetë që Republika e Austrisë të kërkoj këtë kod për Kosovën.

Do t'u isha mirënjohës nëse ju procedoni, sa më shpejt që është e mundshme, të alokoni njërin prej këtyre dy kodeve të pa-alokuara (+383 ose +384) për përdorim nga autoritetet Kosovare. Do t'u isha gjithashtu mirënjohës nëse na informoni që buletini i ITU-se është publikuar.

I juaji sinqerisht,

Aneksi 3: Denominimi i Kosovës në anekset teknike të ITU-së

Në anekset teknike të buletineve të ITU-së, Kosova do të referohet si Kosovo* me fusnotën ‘Ky emërtim është pa paragjykuar pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe mendimin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës’.